# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8386
E hënë, 14 shtator 2026
Çmimi 0. 50 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Pse Kosova po del kaq dobët në PISA?

FAQE 3




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

# KONSTITUOHET KUVENDI, VOTOHET QEVERIA E RE, OPOZITA E KONSIDERON JOKUSHTETUESE



Kuvendi i Kosovës, me 62 vota për, tetë kundër dhe asnjë abstenim, ka votuar qeverinë e re të udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje, duke i siguruar Kurtit mandatin e katërt të kryeministrit të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca e kanë konsideruar Kuvendin e Kosovës të pakonstituuar dhe qeverinë jokushtetuese. Këto dy subjekte politike kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese lidhur me, siç kanë thënë, të gjitha shkeljet që janë bërë në vazhdimësi nga Lëvizja Vetëvendosje pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit

## PROTESTË MADHËSHTORE NË PËRKRAHJE TË ÇLIRIMTARËVE NË HAGË: JU JENI TË PAFAJSHËM, JU PRESIM NË KOSOVË

F. 3

Mijëra qytetarë marshuan nëpër sheshet e Prishtinës të shtunën në mbështetje të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilët po mbahen në paraburgim në Hagë. Më 16 shtator Gjykata Speciale e Kosovës, me seli në Hagë, pritet ta shpallë aktgjykimin ndaj tyre, ndërsa protestues të shumtë në kryeqytetin e Kosovës shprehën bindjen se katër ish-eprorët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm



## OPINION

### EDHE NJË GJYKIM ZVICERAN

F. 7


Auch ein Schweizer Urteil

Nga Mirko PLÜSS

## AKTUALE




### TRUMPI I KËRKON ZELENSKYT T'I NDALOJË GODITJET NDAJ INFRASTRUKTURËS RUSE TË NAFTËS: PO SHKAKTON MUNGESË GLOBALE

F. 2

### POLONIA NUK DO TA BLLOKOJË HAPJEN E KAPITUJVE TË NEGOCIATAVE TË UKRAINËS ME BE-në

F. 8

## EKONOMI



### ÇMIMET LART, PAZARET POSHTË: DY ANËT E TREGUT TË BANESAVE

F. 8

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

# PSE KOSOVA PO DEL KAQ DOBËT NË PISA?

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Mbi 80 për qind të nxënësve 15-vjeçarë në Kosovë, të cilët u janë nënshtruar testeve të Programit për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve, i njohur si PISA, nuk arritën as nivelin bazë në matematikë, shkencë dhe lexim.
Rezultatet e PISA-s për vitin 2025 e renditën sërish Kosovën ndër vendet me performancën më të dobët - e 8-ta nga fundi në mesin e 91 vendeve dhe ekonomive që morën pjesë - dhe nxitën diskutime për gjendjen e sistemit arsimor në Kosovë.
Agon Ahmeti, nga organizata joqeveritare ETEA, e cila fokusohet në përmirësimin e arsimit parauniversitar, thotë se Kosova ka shënuar regres të vazhdueshëm në katër herët që ka marrë pjesë në PISA dhe se, gjatë kësaj periudhe, nuk janë parë reforma apo iniciativa që do të mund të sillnin përmirësim të rezultateve. "Fatkeqësisht, në vitin 2025 kemi rezultate më të dobëta krahasuar me 10 vjet më herët, kur jemi bërë pjesë e këtij studimi", shprehet Ahmeti në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë.
Një nga problemet që Ahmeti veçon është dallimi i madh mes vlerësimeve që marrin nxënësit në shkolla dhe rezultateve në testimet ndërkombëtare.
Ahmeti kritikon qasjen e sistemit arsimor në vend, ku, sipas tij, theksi vazhdon të jetë te mësimi përmendësh dhe matja e memories së nxënësve. "Vlerësohet memoria e nxënësve, se sa është arritur të mbahen mend ca data, ca numra, ca formula, e kështu me radhë", shprehet ai.
Ndërkaq, pyetjet që janë në studimin PISA, thotë Ahmeti, matin logjikën dhe mendimin kritik, ndërsa 15-vjeçarët kosovarë as një mbledhje të thjeshtë nuk arrijnë ta zbërthejnë. "Kemi një situatë ku - t'i biem shkurt e shqip




- këta nxënës, rreth 85 për qind të tyre, janë analfabetë funksionalë", thotë ai në 5 pyetje.
Ahmeti thotë se përgjegjësia për rezultatet e dobëta nuk duhet t'u atribuohet nxënësve. "Nxënësit, në fakt, nuk kanë aspak faj. Nxënësve u është servuar ky sistem", shprehet ai. Sipas Ahmetit, përgjegjësia duhet të ndahet mes institucioneve, shkollave, mësimdhënësve, prindërve dhe shoqërisë në përgjithësi.
Ai veçon edhe rolin e prindërve, duke thënë se, sipas të dhënave të PISA-s, ka pasur rënie prej 10 deri në 15 për qind të interesimit të prindërve për vijimësinë e shkollimit të fëmijëve, nga viti 2022 në vitin 2025.
Përballë rezultateve të dobëta, Ahmeti thotë se hapi i parë duhet të jetë shpallja e arsimit si urgjencë kombëtare. Sipas tij, institucionet duhet të dakordohen për një qasje të përbashkët dhe të ndërtojnë një "pakt shoqëror" për arsimin.
Ai propozon që të përcaktohen tri deri në pesë objektiva afatgjata, të cilat do të mbetnin prioritete pavarësisht prej ndërrimit të qeverive. "Është sektor i tillë, pra do punë sot, për t'i parë frytet ndoshta pas pesë ose dhjetë vjetësh", thotë Ahmeti.
Ai paralajmëron se pasojat e rezultateve të dobëta në arsim shkojnë përtej sistemit shkollor. "Këta 15-vjeçarë pas 15 vjetësh do të jenë në pozita, sepse nuk kemi popull tjetër", thotë Ahmeti, duke shtuar se arsimi është bazë për sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

# TRUMPI I KËRKON ZELENSKYT T'I NDALOJË GODITJET NDAJ INFRASTRUKTURËS RUSE TË NAFTËS: PO SHKAKTON MUNGESË GLOBALE

UASHINGTON, 13 SHTATOR - Donald Trump ka kritikuar sulmet ukrainase ndaj objekteve të karburanteve në Rusi, duke pretenduar se ato po ndikojnë në furnizimin global me naftë.
Presidenti amerikan Donald Trump i ka bërë thirrje presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky t'i ndalojë sulmet ndaj infrastrukturës ruse të karburanteve, duke pretenduar se goditjet ndaj objekteve të naftës dhe karburanteve diesel po kontribuojnë në një mungesë globale.
Trumpi i bëri komentet gjatë qëndrimit në Irlandë në kuadër




të turneut Irish Open, që po zhvillohet në klubin e tij në Doonbeg, raportoi European Pravda.
I pyetur nëse kishte biseduar me Zelenskyn pas bisedës së tij të fundit me presidentin rus Vladimir Putin, Trump u ndal te sulmet ukrainase ndaj objektivave në Rusi. "Zoti Zelensky duhet të bëjë një gjë. Ai duhet të ndalojë së godituri karburantin diesel në Rusi", tha Trump. Ai shtoi se Ukraina mund të vazhdojë të godasë objektiva të tjera, por duhet ta shmangë infrastrukturën e karburanteve. "Le t'i godasë objektivat, por jo karburantin diesel, sepse po shkakton një mungesë të naftës diesel", deklaroi presidenti amerikan.
Sulmet ukrainase ndaj rafinerive, depove dhe objekteve të tjera energjetike ruse janë shtuar gjatë periudhës së fundit, ndërsa Kievi i konsideron këto infrastruktura pjesë të kapaciteteve që mbështesin makinerinë ushtarake të Moskës.
Megjithatë, në deklaratat e tij Trumpi nuk i bëri thirrje presidentit Putin ta ndalojë pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, i cili tashmë ka hyrë në vitin e pestë.

# POLONIA NUK DO TA BLLOKOJË HAPJEN E KAPITUJVE TË NEGOCIATAVE TË UKRAINËS ME BE-në

VARSHAVË, 13 SHTATOR - Varshava zotohet të mos pengojë procesin e integrimit evropian të Ukrainës, ndërsa ministri i Jashtëm polak, Radosław Sikorski, paralajmëron se negociatat me Bashkimin Evropian nuk do të jenë të lehta.
Polonia nuk do ta bllokojë hapjen e kapitujve të negociatave për anëtarësimin e Ukrainës në Bashkimin Evropian, ka deklaruar ministri i Jashtëm polak, Radosław Sikorski, gjatë një konference të përbashkët për medie me homologun e tij ukrainas, Andrii Sybiha, në Kyiv.
Sikorski theksoi se rruga drejt anëtarësimit në BE do të jetë e vështirë për Ukrainën, ashtu siç ishte edhe për Poloninë gjatë procesit të saj të integrimit, transmeton Telegrafi. "Por Polonia nuk do ta bllokojë hapjen e kapitujve të negociatave. Kjo nuk do të thotë se mbyllja e tyre do të vijë shpejt, por Ukraina, sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, tashmë është e gatshme për negociata", deklaroi ai.
Ministri polak shtoi se Varshava pret që Ukraina të përfundojë edhe procesin e zbatimit të Marrëveshjes së Asociimit me BE-në, përfshirë Zonën e Thellë dhe Gjithëpërfshirëse të Tregtisë së Lirë (DCFTA). "Ju mund të jeni pjesë e tregut të përbashkët edhe para se të anëtarësoheni në BE", tha Sikorski.
Duke komentuar sulmet e fundit ruse ndaj Ukrainës, Sikorski paralajmëroi se kërcënimi rus tashmë prek drejtpërdrejt sigurinë evropiane. "Ukraina dhe Polonia nuk do ta lejojnë Rusinë të na dominojë. Kjo nuk do të ndodhë dhe nuk do të kthehet më. Ne po luftojmë gjithashtu që Ukraina të vendosë vetë se kush ka të drejtë të jetë në Ukrainë, dhe jo Putini", deklaroi ai.
Sipas ministrit polak, bombardimet ruse vetëm disa qindra metra larg kufirit me Poloninë duhet të shërbejnë si dëshmi e qartë se siguria e dy vendeve është e lidhur ngushtë. "Le të jetë kjo prova përfundimtare për të gjithë në atdheun tim se siguria e Polonisë dhe Ukrainës është e pandashme dhe se shfaqja e solidaritetit me të gjithë Ukrainën, si dhe me çdo ukrainas veç e veç - me ata që jetojnë në Poloni dhe me ata që duan të hyjnë në Poloni - është ndërtimi i solidaritetit mes popujve tanë", u shpreh Sikorski.
Ai e përshkroi situatën me një paralajmërim të drejtpërdrejtë: "Terrorizmi rus nuk po troket vetëm në derë - ai është brenda shtëpisë".
Sikorski tha se lufta hibride ruse tashmë po zhvillohet edhe përmes mjeteve kinetike, duke iu referuar sulmeve dhe bombardimeve që kanë pasoja të drejtpërdrejta për sigurinë e vendeve fqinje.
Ndërkohë, më 1 shtator, Hungaria refuzoi sërish të miratojë rezultatet e procesit të shqyrtimit për kapitujt 2 dhe 3 të negociatave të Ukrainës me BE-në.
Budapesti kërkon që Kyiv të



ndërmarrë hapa të caktuar legjislativë në lidhje me të drejtat e pakicës kombëtare hungareze në Ukrainë.
Kjo situatë e vendos Poloninë në një pozicion të ndryshëm nga Hungaria, pasi Varshava po sinjalizon qartë se nuk synon të pengojë hapjen e kapitujve të negociatave, edhe pse procesi i mbylljes së tyre pritet të jetë i gjatë dhe kompleks.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# PROTESTË MADHËSHTORE NË PËRKRAHJE TË ÇLIRIMTARËVE NË HAGË: JU JENI TË PAFAJSHËM, JU PRESIM NË KOSOVË

Mijëra qytetarë marshuan nëpër sheshet e Prishtinës të shtunën në mbështetje të katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilët po mbahen në paraburgim në Hagë. Më 16 shtator Gjykata Speciale e Kosovës, me seli në Hagë, pritet ta shpallë aktgjykimin ndaj tyre, ndërsa protestues të shumtë në kryeqytetin e Kosovës shprehën bindjen se katër ish-eprorët e UÇK-së do të shpallen të pafajshëm

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

**Prishtinë, 13 shtator** - Nga qytete të ndryshme të Kosovës, shumë qytetarë u mblodhën të shtunën në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë dhe në sheshet e tjera të kryeqytetit në "Marshin për Liri" të organizuar katër ditë para shpalljes së verdiktit përfundimtar për katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.

Flamujt kuqezi dhe emblemat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dominuan në sheshet e Prishtinës gjatë marshit. Pjesëmarrësit mbanin flamuj të Kosovës, të Shqipërisë dhe të UÇK-së si dhe pankarta në mbështetje të katër ish-krerëve të UÇK-së.

Në mesin e folësve në marsh ishin kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, dhe kryetari i AAK-së, Ardian Gjini. Folën edhe përfaqësues të veteranëve dhe familjeve të dëshmorëve.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka deklaruar se një vendim i padrejtë ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të ishte dënim për Kosovën, duke thënë se padrejtësia nuk pranohet dhe se historia e vendit nuk duhet të rishkruhet.

Kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, në fjalimin e tij në "Marshin për Liri", ka thënë se ish-krerët e UÇK-së dhe luftëtarët e saj nuk duhet të persekutohen, duke theksuar se ata luftuan kundër forcave që, sipas tij, kanë kryer krime ndaj popullatës shqiptare në Kosovë.

Ndërkaq Buna Mustafa, vajza e Salih Mustafës-Cali, i dënuar nga Gjykata Speciale në Hagë, ka thënë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk mund të barazohet me forcat serbe, duke theksuar se lufta ishte për liri dhe çlirim. "Një ushtri që u zgjua nga populli dhe krijoi uniformën e vet, me të cilën nuk terrorizoi asnjë civil, nuk dhunoi e nuk abuzoi me asnjë grua e asnjë fëmijë të përkatësisë tjetër. Prandaj, nderoj emblemën e vet, përkundër regjimit fashist serb që na i shkaktoi për mbi 13 000 viktima civile, na i vrau e na i masakroi 1 400 fëmijë. Dhunoi e abuzoi seksualisht me 20 000 nëna e motra tonat. I zhduku 1 500 bashkë-qytetarë dhimbjen e të cilëve familjet e tyre nuk mund ta shuajnë dot kurrë. Kreu 400 masakra rreth e këmbë Kosovës. Krijuan varreza masive të shqiptarëve që edhe në ditët e sotme po zbulohen. Na shkaktuan dëme kolosale materiale në vendin tonë. Andaj, hendeku është aq i madh saqë drejtësia e vërtetë nuk mund t'i barazojë kurrë ushtarët çlirimtarë me xhelatët serbë", ka thënë ajo.

Katër ditë para verdiktit, protestuesit në Prishtinë përcollën mesazhe për drejtësi dhe mbështetje për të çlirimtarët, ndërsa rrugët e kryeqytetit u mbushën me simbole të UÇK-së.

Platforma qytetare "Liria ka Emër" ka falënderuar nga zemra rreth 100 mijë qytetarë që iu bashkuan Marshit për Liri në Prishtinë, duke e shndërruar kryeqytetin në një zë të fuqishëm për lirinë, drejtësinë dhe të vërtetën e luftës çlirimtare të Kosovës. "Qytetarë nga të gjitha trojet shqiptare, nga çdo komunë e Kosovës, si dhe bashkatdhetarë nga diaspora, marshuan sot së bashku, pa dallime, me një mesazh të vetëm: Liri për çlirimtarët! Falënderojmë familjet e dëshmorëve, veteranët dhe invalidët e luftës, bashkëluftëtarët, qytetarët, diasporën, artistët, sportistët, përfaqësuesit politikë, organizatat, bizneset, mediat, vullnetarët dhe secilin që kontribuoi që ky marsh të ishte një manifestim i madh, paqësor dhe dinjitoz. Sot Kosova dëshmoi edhe një herë se kur bëhet fjalë për lirinë, për UÇK-në dhe për njerëzit që morën përgjegjësinë për vendin në ditët më të vështira të historisë sonë, ne dimë të bëhemi bashkë. Marshi i sotëm ishte një mesazh i fuqishëm solidariteti me Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, por mbi të gjitha ishte një mesazh për të vërtetën, drejtësinë dhe historinë e Kosovës. Tani sytë e Kosovës janë drejt 16 shtatorit", është thënë në komunikatën e "Liria ka Emër".

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK) ka reaguar pas Marshit për Liri të mbajtur në Prishtinë, duke e cilësuar pjesëmarrjen e qytetarëve mesazh të fuqishëm në mbështetje të çlirimtarëve.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, OVLUÇK ka falënderuar bashkëluftëtarët dhe qytetarët që morën pjesë në marshim. "Populli foli edhe njëherë. Faleminderit bashkëluftëtarë e qytetarë! Këta zëra nuk mund të injorohen", thuhet në reagimin e OVLUÇK-së.










# KONSTITUOHET KUVENDI, VOTOHET QEVERIA E RE, OPOZITA E KONSIDERON JOKUSHTETUESE

Kuvendi i Kosovës, me 62 vota për, tetë kundër dhe asnjë abstenim, ka votuar qeverinë e re të udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje, duke i siguruar Kurtit mandatin e katërt të kryeministrit të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës dhe Aleanca e kanë konsideruar Kuvendin e Kosovës të pakonstituuar dhe qeverinë jokushtetuese. Këto dy subjekte politike kanë paralajmëruar se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese lidhur me, siç kanë thënë, të gjitha shkeljet që janë bërë në vazhdimësi nga Lëvizja Vetëvendosje pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës e ka votuar qeverinë e re të udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje me 62 vota për, tetë kundër dhe asnjë abstenim, duke i siguruar Kurtit mandatin e katërt të kryeministrit të Kosovës.

LV-ja ka 53 deputetë në Kuvend, por qeveria e re u mbështet edhe nga nëntë deputetë të komuniteteve joshumicë - tetë nga pakicat joserbe dhe nga Nenad Rashiqi i pakicës serbe.

Në seancë nuk morën pjesë deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës, të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Aleancës. Tetë nga nëntë deputetët e Listës Serbe morën pjesë dhe votuan kundër.

Përbërja e kabinetit qeveritar mbetet e njëjtë me atë të qeverisë së tretë të drejtuar nga Kurti.

Gjatë fjalimit të tij, Kurti tha se nuk do të prezantojë ndonjë program apo agjendë të re pasi që tha se zgjedhjet e përsëritura e kanë ndërprerë qeverisjen që do të vazhdojë edhe në mandatin e ri.

Kurti tha se vizioni i Lëvizjes Vetëvendosjes do jetë i përqendruar te mirëqenia e qytetarëve dhe mbrojtja e familjeve. "Sot ky mandat është për ta kthyer fuqishëm sigurinë dhe mirëqenien në përditshmërinë e qytetarit", tha Kurti.

Në politikën e jashtme, Kurti tha se synimi kryesor mbetet marrja e statusit të kandidatit për anëtarësim në BE, ndërsa deri në vitin 2030 synohet përparimi në bisedimet për anëtarësim. Ai premtoi zgjerimin e marrëdhënieve me vendet e NATO-s dhe BE-së, forcimin e diplomacisë dhe përpjekjet për njohjen e pasaportës së Kosovës në më shumë shtete.

Në mbrojtje, qeveria synon të ndajë mbi 1 miliard euro në katër vjet për ushtrinë. Kurti paralajmëroi zhvillimin e industrisë ushtarake për prodhimin e municionit, dronëve dhe robotëve, krijimin e një njësie të përbashkët ushtarake me Shqipërinë dhe themelimin e Xhandarmërisë së Kosovës.

Në drejtësi, ai premtoi vazhdimin e vetingut, themelimin e një gjykate për çështje familjare dhe të një prokurorie të specializuar për krimin e organizuar dhe korrupsionin. Proceset gjyqësore synohet të digjitalizohen.

Në arsim, qeveria synon dyfishimin e buxhetit për bursa, zgjerimin e çerdheve dhe arsimit parafillor, hapjen e pesë gjimnazeve të specializuara dhe shtimin e 10 profileve në arsimin dual. Interneti i shpejtë dhe falas synohet të shtrihet në 1 000 institucione parauniversitare.

Në shëndetësi, Kurti premtoi mjek familjar për çdo qytetar, kontrolle të rregullta dhe programe për zbulimin e hershëm të kancerit. Sigurimet shëndetësore u tha se pritet të funksionalizohen, ndërsa buxheti për barnat esenciale të rritet deri në 100 milionë euro. U paralajmërua edhe ndërtimi i spitaleve të reja në Mitrovicë dhe Ferizaj.

Në mirëqenie sociale, shtesat për fëmijë do të dyfishohen, ndërsa paga minimale prej 500 eurosh nuk do të tatohet. Qeveria synon që paga mesatare në sektorin publik të kalojë 1 000 euro dhe ta nisë zbatimin e pagës së 13-të në sektorin publik dhe privat.

Në ekonomi, Kurti premtoi një program prej 1 miliard eurosh për prodhim dhe industri si dhe themelimin e Bankës Zhvillimore. Brenda mandatit, ai tha se do të nisë themelimi i një kompanie ajrore me kapital publik.

Për transportin, synohet krijimi i një rrjeti të përbashkët në tërë Kosovën dhe një biletë mujore e subvencionuar prej 10 eurosh.

Në turizëm, për projektin e Brezovicës parashikohen investime deri në 500 milionë euro.

Në energji, Kurti tha se synon rritjen e prodhimit nga era dhe dielli, ndërsa në infrastrukturë premtoi nisjen e hekurudhës Gjakovë - Shkodër dhe projekte të tjera rrugore e hekurudhore. Synimi tha se është që investimet kapitale vjetore të kalojnë 1 miliard euro.

Për diasporën, Kurti shtoi se synon të mbështesë deri në 100 milionë euro investime të mërgatës në Kosovë dhe t'i zgjerojë shërbimet konsullore digjitale.

### Përbërja e kabinetit qeveritar "Kurti 4"

Kryeministër: Albin Kurti

Zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës: Glauk Konjufca

Zëvendëskryeministre e dytë dhe ministre e Drejtësisë: Donika Gërvalla

Zëvendëskryeministër i tretë për

çështje të pakicave dhe bashkëpunim: Fikrim Damka
Ministër i Financave: Hekuran Murati
Ministër për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare: Andin Hoti
Ministër i Mbrojtjes: Ejup Maqedonci
Ministër i Punëve të Brendshme: Xhelal Sveçla
Ministër i Digjitalizimit dhe Administratës Publike: Lulëzon Jagxhiu
Ministër i Shëndetësisë: Arben Vitia
Ministër i Arsimit dhe Shkencës: Hajrulla Çeku
Ministre e Kulturës dhe Turizmit: Saranda Bogujevci
Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal: Elbert Krasniqi
Ministër i Sportit dhe Rinisë: Blerim Gashani
Ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor: Fitore Pacolli
Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural: Armend Muja
Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit: Dimal Basha
Ministre e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit: Mimoza Kusari
Ministre e Ekonomisë: Artane Rizvanolli
Ministër për Komunitete dhe Kthim: Nenad Rashiq
Ministër për Zhvillim Rajonal: Rasim Demiri.

## Kuvendi konstituohet pa nënkryetarin e PDK-së

Kuvendi u shpall i konstituuar nga kryeparlamentarja Albulena Haxhiu të dielën pasi u zgjodh nënkryetari nga radhët e LDK-së dhe ata të komuniteteve pakicë.
Partia Demokratike e Kosovës nuk mori pjesë në seancë dhe paraprakisht e kishte tërhequr kandidaturën e Vlora Çitakut për nënkryetare.
Kryesuesja e seancës, Albulena Haxhiu, tha se Kuvendi "nuk mund të mbetet peng i asnjë subjekti politik".
Kandidati i LDK-së për nënkryetar, Kujtim Shala, u zgjodh me 75 vota.
Pas tetë kandidaturave të dështuara nga Lista Serbe, u zgjodh edhe deputetja serbe Tanja Vujoviq. Ajo mori votat e LV-së dhe të disa deputetëve të LDK-së.
Nga komunitetet joserbe u zgjodh deputetja boshnjake Emilija Rexhepi.
Pas votimit të nënkryetarëve, Haxhiu deklaroi se Kuvendi "konsiderohet i konstituuar".
Në një vendim të mëhershëm, Gjykata Kushtetuese kishte lënë të hapur mundësinë që Kuvendi, në rrethana të caktuara, të funksionojë edhe pa një nga anëtarët e Kryesisë, nëse zgjedhja e tij pamundësohet dhe Kryesia ka kuorum për vendimmarrje.
Si një rrethanë e tillë ishte përmendur rasti kur një deputet ose grup parlamentar që ka të drejtë të propozojë anëtar të kryesisë nuk e ushtron këtë të drejtë ose e pengon procesin.
PDK-ja e ka kundërshtuar interpretimin se Kuvendi është konstituuar pa nënkryetarin e saj.
Kjo parti këmbëngul se nuk e ka refuzuar propozimin për nënkryetar, por është tërhequr përkohësisht nga procesi në pritje të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Sipas PDK-së, për këtë arsye Kuvendi nuk mund të konsiderohet i konstituuar, pasi nuk ka nënkryetar nga radhët e saj. "Duke mos refuzuar, Kuvendi s'ka mundur të konstituohet", tha deputeti Përparim Gruda para selisë së PDK-së në një konferencë për medie.
Gruda pyeti se nëse konsiderohet se PDK-ja ka refuzuar të propozojë kandidat për nënkryetar sepse mungoi në këtë seancë, atëherë pse LV-së nuk iu mohua e drejta për ta propozuar kryetarin e Kuvendit kur nuk thërriste vazhdimin e seancës çdo 48 orë, siç përcaktohet me Rregulloren e Kuvendit, me kërkesën që paraprakisht të arrihet marrëveshje me partitë e tjera për çështjen e presidentit.
PDK-ja ka bërë me dije se në kërkesën që synon ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese do të përfshijë jo vetëm çështjen e konstituimit të Kuvendit, por edhe formimin e qeverisë së re.
Tashmë ka nisur rrjedhja e afatit prej 60 ditësh për zgjedhjen e presidentit të Kosovës. Nëse presidenti nuk zgjidhet brenda këtij afati, vendi shkon sërish në zgjedhje të jashtëzakonshme parlamentare.

## Opozita: Qeveria është jokushtetuese dhe jolegjitime, do t'i drejtohemi Gjykatës Kushtetuese

Partia Demokratike e Kosovës e konsideron Kuvendin e Republikës së Kosovës të pakonstituuar dhe qeverinë e votuar jokushtetutese.
Kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Arian Tahiri dhe deputeti Përparim Gruda, në një konferencë për medie kanë paralajmëruar se PDK do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me të gjitha shkeljet që janë bërë në vazhdimësi nga Lëvizja Vetëvendosje pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit.
Tahiri u shpreh se Kurti ka luajtur gjatë gjithë kësaj kohe me institucionet, e ka shpërfillur Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. "Procedimet e sotme dhe konstatimet e tyre se Kuvendi është konstituuar janë përtej afateve kushtetuese dhe gjithçka që del nga ky Kuvend, ne do ta dërgojmë për shqyrtim të ligjshmërisë në Gjykatën Kushtetuese. Kosova duhet të funksionojë sipas rendit kushtetues dhe jo sipas një rendi që tenton ta krijojë Kurti për interesat e veta politike. Ekspertët e PDK-së tashmë janë duke punuar për përgatitjen e rastit, i cili do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për procesin në tërësi", shtoi ai.
Sipas PDK-së, Kurti dhe LV-ja kanë shkelur afatet kushtetuese për interesa të ngushta politike dhe kanë tentuar të luajnë edhe me figura politike të subjekteve opozitare. "Si Parti Demokratike e Kosovës qëndrimin tonë e kemi bërë publik edhe në seancën e disa ditëve më parë, ku nuk u votua nënkryetarja e PDK-së", theksoi Tahiri.
Ndërsa deputeti Përparim Gruda tha se Lëvizja Vetëvendosje nuk mund t'i shkelë afatet kushtetuese dhe pastaj PDK-së t'ia marrë një të drejtë kushtetuese. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet KO124/25, KO193/25 dhe KO196/25, si dhe KO265/25, kanë përcaktuar qartë se Kuvendi nuk mund të konsiderohet i konstituuar pa u zgjedhur të gjithë nënkryetarët e tij. Në këtë rast, Kuvendi nuk është konstituuar, pasi nuk është zgjedhur nënkryetari nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Keqinterpretimi që po i bëhet aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, konkretisht pjesës që përcakton pasojat juridike të mosushtrimit të së drejtës për ta propozuar nënkryetarin e Kuvendit, nuk mund të zbatohet në rastin e PDK-së", tha ai.
Gruda listoi tri argumente lidhur me shkeljet që do t'i adresojë PDK-ja në Kushtetuese. "E para, PDK-ja nuk ka refuzuar ushtrimin e së drejtës së saj kushtetuese për ta propozuar nënkryetarin e Kuvendit. Përkundrazi, në letrën zyrtare që kemi dërguar kemi sqaruar shprehimisht se nuk heqim dorë nga e drejta jonë për të propozuar, por përmbahemi përkohësisht nga ushtrimi i saj, derisa Gjykata Kushtetuese të sqarojë rrethanat kushtetuese të krijuara rreth konstituimit të Kuvendit. Ka dallim thelbësor ndërmjet heqjes dorë nga një e drejtë kushtetuese dhe pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të saj për shkak të një kontesti kushtetues që kërkon interpretim nga Gjykata Kushtetuese. E dyta, afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit ka përfunduar më 7 gusht. Pastaj, vetë Lëvizja Vetëvendosje vendosi si afat politik datën 6 shtator. Asnjëri prej këtyre afateve nuk u respektua. Përkundër kësaj, ne kemi marrë pjesë edhe në dy seanca të thirrura jashtë këtyre afateve, duke treguar vullnet që Kuvendi të konstituohej. Në të dyja rastet, në vend të konstituimit të Kuvendit, pati vetëm manovra procedurale dhe lojëra absurde politike të Vetëvendosjes, të cilat e pamundësuan përfundimin e procesit. Nuk mund të funksionojë rendi kushtetues sipas standardit që njëra palë i shkel të gjitha afatet, thërret seanca kur dëshiron vetë, nuk e përfundon konstituimin kur ne marrim pjesë dhe, në fund, thërret një seancë tjetër jashtë çdo afati dhe deklaron se Kuvendi qenka konstituuar pa ne. E treta, një interpretim i tillë do të krijonte një precedent jashtëzakonisht të rrezikshëm kushtetues: pala që ka shkaktuar dhe vazhduar shkeljen e afateve kushtetuese do të përfitonte juridikisht pikërisht nga shkelja e vet. Në vend që shkelja të prodhonte përgjegjësi kushtetuese, ajo do të përdorej si bazë për t'ia mohuar një subjekti tjetër parlamentar një të drejtë që ia garanton vetë Kushtetuta", ka theksuar Gruda.
Edhe kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka thënë se qeveria që u votua të dielën është jokushtetuese dhe jolegjitime. "Aleanca do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese dhe presim adresim me prioritet nga kjo e fundit, meqë themelet e kushtetueshmërisë po lëkunden", ka shkruar Gjini në "Facebook".



# EDHE NJË GJYKIM ZVICERAN

**Të mërkurën një gjykatë speciale do të vendosë nëse ish-drejtuesi i UÇK-së, Hashim Thaçi, është kriminel lufte. Për herë të parë, një bashkëpunëtor i afërt tregon se si ushtria kryengritëse u mbështet nga Zvicra me para dhe armë**

Nga Mirko PLÜSS

### “Atdheu” në Bad Ragaz

PRISHTINË, 13 SHTATOR - Të mërkurën në mbrëmje, në shoqatën kulturore “Atdheu” në Bad Ragaz, shqiponja e zezë dykrenare është e pranishme në flamuj dhe postera. Rreth tre duzina burra dhe disa fëmijë dëgjojnë një fjalim dhe në fund bashkohen në një thirrje që sa vjen e forcohet: “U-Ç-K! U-Ç-K!” - ndërsa thërrasin, burrat mbajnë lart flamuj dhe pankarta të UÇK-së, siç tregojnë fotografitë dhe videot e asaj mbrëmjeje.
Kanë kaluar më shumë se një çerek shekulli që kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇK, u shpërbë. Por në diasporën kosovare ajo është më e pranishme se prej shumë kohësh. Jo vetëm në Bad Ragaz, por edhe në Basel, Uster apo Zürich organizohen tubime. “Liri për Çlirimtarët” është një nga sloganet.
Çlirimtarët janë Hashim Thaçi dhe tre ish-kuadro të tjerë të UÇK-së. Thaçi ishte udhëheqës i UÇK-së, e cila në luftën e Kosovës në fund të viteve 1990, falë mbështetjes ajrore të NATO-s, fitoi luftën kundër forcave serbe. Më vonë ai u bë kryeministri i parë i shtetit të ri ballkanik, Kosovës. Por tani trashëgimia e tij po vihet në pikëpyetje.
Prej gati gjashtë vitesh, Thaçi mbahet në paraburgim në Holandë. Ai dhe tre të bashkakuzuarit e tij përballen para një gjykate speciale për Kosovën në Hagë me akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Sipas aktakuzës, ata mbajnë përgjegjësi për krimet e UÇK-së, edhe nëse nuk i kanë kryer personalisht ato.
Bëhet fjalë për mizori të kryera në burgje sekrete. Gjithashtu bëhet fjalë për vrasje të civilëve në më shumë se 100 raste. Të katër i mohojnë akuzat. Trupat serbe dhe jugosllave ishin përgjegjëse për shumë më tepër viktima; disa prej përgjegjësve të tyre tashmë janë dënuar.
Vendimi merret të mërkurën e ardhshme. Procesi hedh gjithashtu dritë mbi rolin e Zvicrës. Sepse pak vende të tjera të Evropës Perëndimore janë të lidhura aq ngushtë me ngritjen e UÇK-së sa Zvicra.

### Nga politika në luftë

Në vitet 1990, në Zvicër ishte veçanërisht aktive LPK-ja, Lëvizja Popullore e Kosovës. Ishte një organizatë politike me funksionarë të zgjedhur, gazetën e saj në Zvicër dhe një rrjet të gjerë në diasporë.
Por sa më shumë afrohej lufta e Kosovës e viteve 1998 dhe 1999, aq më shumë zbehej kufiri mes saj dhe ushtrisë së fshehtë UÇK.
LPK-ja mblidhte para për UÇK-në, organizonte materiale dhe mobilizonte burra për luftë. Në vitin 1999, mediat zvicerane raportuan se nga periferitë e Zürichut niseshin njëra pas tjetrës autobusë me të rinj drejt Ballkanit.
Kur autobusët niseshin, dëgjoheshin të njëjtat thirrje që sot përsëri jehojnë në lokalet e shoqatave në të gjithë vendin: “U-Ç-K! U-Ç-K!”

### Truku me kamionët

Kjo dinamikë pasqyrohet edhe në dokumentet gjyqësore në Hagë. Në to, një dëshmitar përmend emrat e burrave që në Zvicër kryenin punë organizative për UÇK-në. Përmenden gjithashtu struktura në kantone të ndryshme, grupe burrash që udhëtonin së bashku nga Zvicra drejt Shqipërisë, si dhe një gazetë e prodhuar në Biel dhe Lausanne, e cila publikonte komunikata të UÇK-së. “Zvicra ishte me rëndësi të jashtëzakonshme për themelimin e UÇK-së.” Kështu thotë një burrë që sot punon si taksist në St. Gallen. Dikur ai ishte pjesë e rrethit më të ngushtë përreth Hashim Thaçit.
Agush Buja - me atlete, xhinse, një xhaketë shiu blu, flokë të bardhë dhe një simbol të kuq të Kosovës në gjoks - është në fillim të të gjashtëdhjetave. Rrëfimet e tij gjatë një takimi këtë javë të çojnë tre dekada pas në kohë.
Në atë kohë Buja ishte sekretar i udhëheqjes së LPK-së jashtë vendit. Ishte një detyrë e lartë në një kohë kur politika kosovare bëhej kryesisht nga mërgimi.

### A do ta quante veten edhe ai anëtar të UÇK-së?

“LPK-ja dhe UÇK-ja nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra”, thotë Buja. Organizata e armatosur kishte lindur “drejtpërdrejt nga programi i LPK-së”.
Që nga fillimi i viteve 1980, edhe në Zvicër, përmes demonstratave dhe veprimtarisë politike, ishte përpjekur të shkëpuste Kosovën nga sundimi jugosllav. Me kalimin e viteve, lufta e armatosur kishte dalë gjithnjë e më shumë në plan të parë: “Në një moment e kuptuam: duhet t’i arrijmë qëllimet

NZZ AM SONNTAG SCHWEIZ 11


Der UCK-Chef Hashim Thaci (in Zivil) während einer Pressekonferenz im März 1999 an einem geheimen Ort in Kosovo. Der Kämpfer hinter ihm trägt ein Schweizer Sturmgewehr.

Eines der wichtigsten Kapitel der Geschichte dieses Kampfes beginnt in einem Restaurant in Winterthur.

## Auch ein Schweizer Urteil

Am Mittwoch urteilt ein Sondertribunal, ob der frühere UCK-Chef Hashim Thaci ein Kriegsverbrecher ist. Erstmals erzählt nun ein enger Vertrauter, wie die Rebellenarmee aus der Schweiz mit Geld und Waffen unterstützt wurde. **Von Mirko Plüss**

Mittwochabend im Kulturverein «Atdheu» in Bad Ragaz: Auf Flaggen und Plakaten prangt der schwarze Doppeladler. Rund drei Dutzend Männer und einige Kinder lauschen einer Rede und stimmen schliesslich in einen anschwellenden Sprechchor ein: «U-C-K! U-C-K!» – parallel zum Kampfruf halten die Männer Flaggen und Transparente der UCK hoch, wie Bilder und Videos des Abends zeigen.
Es ist über ein Vierteljahrhundert her, dass sich die Befreiungsarmee von Kosovo UCK aufgelöst hat. Doch in der kosovarischen Diaspora ist sie so präsent wie lange nicht mehr. Nicht nur in Bad Ragaz, auch in Basel, Uster oder Zürich gibt es Zusammenkünfte. «Liri per Clirimtaret», «Freiheit für die Befreier», lautet einer der Slogans.
Die Befreier, das sind Hashim Thaci und drei weitere ehemalige UCK-Kader. Thaci war Anführer der UCK, die im Kosovokrieg Ende der 1990er Jahre dank der Luftunterstützung der Nato den Sieg gegen die Serben errang. Er wurde später erster Ministerpräsident des neuen Balkanstaats Kosovo. Doch nun steht sein Erbe auf dem Prüfstand.
Seit fast sechs Jahren sitzt Thaci in den Niederlanden in Haft. Ihm und den drei Mitangeklagten werden vor einem Kosovo-Sondertribunal in Den Haag Kriegsverbrechen und Verbrechen gegen die Menschlichkeit vorgeworfen. Sie trügen die Verantwortung für die UCK-Verbrechen, auch wenn sie diese nicht persönlich begangen hätten, so die Anklage. Die Rede ist von Greueltaten in Geheimgefängnissen. Es geht auch um Morde an Zivilisten in über 100 Fällen. Alle vier bestreiten die Vorwürfe. Serbische und jugoslawische Truppen waren für weitaus mehr Tote verantwortlich; mehrere ihrer Verantwortlichen wurden bereits verurteilt.
Das Urteil fällt am kommenden Mittwoch. Das Verfahren wirft auch ein Schlaglicht auf die Rolle der Schweiz. Denn kaum ein anderes westeuropäisches Land ist mit dem Aufstieg der UCK so eng verbunden.
In den 1990er Jahren trat in der Schweiz vor allem die LPK, die kosovo-albanische Volksbewegung, offen in Erscheinung. Es handelte sich um eine politische Organisation mit gewählten Funktionären, einer eigenen Zeitung in der Schweiz und einem weitverzweigten Netz in der Diaspora. Doch je näher der Kosovokrieg von 1998 und 1999 rückte, desto verschwommener wurde die Trennlinie zur Untergrundarmee UCK.
Die LPK sammelte Geld für die UCK, sie organisierte Material und mobilisierte Männer für den Kampf. 1999 berichteten Schweizer Medien, wie von Zürcher Aussenquartieren aus ein Reisecar nach dem anderen, voll mit jungen Männern, Richtung Balkan aufbrach. Als die Busse losfuhren, wurden jene Rufe skandiert, die heute wieder in Vereinslokalen im ganzen Land widerhallen: «U-C-K! U-C-K!»

### Der Trick mit den Camions

Diese Dynamik spiegelt sich auch in den Verfahrensakten von Den Haag wider. Darin nennt etwa ein Zeuge die Namen von Männern, die in der Schweiz organisatorische Arbeit für die UCK leisteten. Genannt werden auch Strukturen in den Kantonen, Gruppen von Männern, die gemeinsam aus der Schweiz nach Albanien reisten, oder eine in Biel und Lausanne produzierte Zeitung, die UCK-Communiqués verbreitete.
«Die Schweiz war bei der Gründung der UCK von grösster Bedeutung.» So sagt es ein Mann, der heute in St. Gallen Taxi fährt. Und der einst zum innersten Zirkel rund um Hashim Thaci gehörte.
Agush Buja – Turnschuhe, Jeans, blaue Regenjacke, weisses Haar und ein roter Kosovo-Anstecker an der Brust – ist Anfang sechzig. Seine Erzählungen bei einem Treffen diese Woche führen drei Jahrzehnte zurück. Buja war damals Sekretär der Auslandsführung der LPK. Ein hohes Amt zu einer Zeit, in der die kosovarische Politik vor allem aus dem Exil gemacht wurde. Würde er sich selber auch als UCK-Mitglied bezeichnen? «LPK und UCK kann man nicht auseinanderhalten», sagt Buja. Die bewaffnete Organisation sei ja «direkt aus dem Programm der LPK hervorgegangen».
Seit Anfang der 1980er Jahre habe man, auch in der Schweiz, mit Demonstrationen und politischer Arbeit versucht, Kosovo aus der jugoslawischen Herrschaft zu lösen. Über die Jahre sei dann der bewaffnete Kampf in den Vordergrund gerückt: «Wir wussten irgendwann: Wir müssen unsere Ziele anders erreichen.»
Buja war bereits in den 1980er Jahren in die Schweiz geflüchtet. Der spätere kosovarische Präsident Hashim Thaci lebte ab 1994 im Land, wohnte in Dietikon und studierte an der Universität Zürich osteuropäische Geschichte. Buja erzählt, er habe Thaci damals kennengelernt und «gefördert». «Ich habe ihn in einen albanischen Kulturverein in St. Gallen geholt.» Später sei der Kontakt intensiver geworden. Die beiden bewegten sich in einem Kreis, aus dem innerhalb weniger Jahre ein Teil der politischen und militärischen Elite Kosovos hervorging.
Eines der wichtigsten Kapitel dieser Geschichte beginnt in Winterthur. Dort traf sich bereits Anfang der neunziger Jahre eine Gruppe von Aktivisten und rief den sogenannten Heimatfonds (Vendlindja Therret) ins Leben. So kann man es in Berichten von Zeitzeugen nachlesen. Der Fonds wurde über die Jahre zum finanziellen Rückgrat der UCK und ermöglichte schliesslich ganz direkt den Kauf von Waffen und Munition.
Agush Buja war damals mit dabei und bestätigt die Erzählungen, die so in der Schweiz bisher nur wenigen bekannt waren. «Die Spitze der LPK traf sich 1993 im Saal eines Winterthurer Restaurants und hat eine zentrale Frage diskutiert: Wie sollte der Kampf finanziert werden?» Die Dimensionen des Fonds dürften vorübergehend enorm gewesen sein. Allein in der Schweiz, sagt Buja, habe es mehr als 1000 Personen gegeben, die berechtigt gewesen seien, Geld von der Diaspora einzusammeln. «Gespendet haben Zehntausende.»
Die Schweiz liess den kosovo-albanischen Aktivisten beträchtlichen Spielraum. Im Juli 1998, als der Kosovokrieg schon in vollem Gange war, wurde die Bundesanwaltschaft aktiv. Sie liess das Konto des Heimatfonds sperren. Buja wurde kurzzeitig verhaftet, seine Wohnung und das Büro des Fonds in Aarau durchsucht.
Die Ermittler befragten Buja. Er hatte einen grösseren Betrag nach Albanien geschickt. Ob damit Waffen gekauft worden seien? «Ich weiss es nicht», sagte er. Und er bleibt auch heute noch dabei. Das Geld sei für alles bestimmt gewesen, was die UCK und die Bevölkerung benötigt hätten: Essen, Kleider – «vielleicht auch Waffen». Das Konto wurde später wieder freigegeben und das Verfahren gegen Buja 2004 eingestellt. Auch in anderen Fällen von mutmasslichen Waffenkäufen kam es nie zu Verurteilungen durch den Bund, wie die Bundesanwaltschaft auf Anfrage schreibt. Dies unter anderem, weil Beschuldigte flohen oder in Albanien belangt werden konnten. Mehrere Fälle wurden an die Kantone abgegeben.
Eine Aktion, die in Kreisen ehemaliger Kosovo-Aktivisten heute noch erzählt wird, zeigt, wie man die Behörden damals täuschte. Anfang 1999 beschafften UCK-Unterstützer mehrere Dutzend ausgemusterte Schweizer Militärlastwagen und fuhren sie nach Albanien. Man liess es für die Behörden in der Schweiz und Italien so aussehen, als würden die Lastwagen einzig dem Transport humanitärer Güter dienen. Doch gemäss Aktivisten wurden sie in Albanien mit Waffen vollgeladen und schliesslich von den Bodentruppen in Kosovo für den Kampf genutzt.

### Vorwürfe aus dem Tessin

Die Schweiz spielt in der ganzen Geschichte eine bemerkenswerte Rolle. Sie gewährte Raum für die politische Arbeit der späteren UCK-Führer, beteiligte sich ab 1999 an der Nato-geführten Friedensmission Kosovo Force (Kfor) und anerkannte Kosovo 2008 bereits zehn Tage nach dessen Unabhängigkeitserklärung.
Gleichzeitig waren es ausgerechnet zwei Tessiner, die schwere Vorwürfe gegen die UCK ins Rollen brachten: die frühere Bundesanwältin und Haager Chefanklägerin Carla Del Ponte und der mittlerweile verstorbene Europarat-Sonderberichterstatter Dick Marty. Ihre gerichtlich nie belegten Vorwürfe, wonach es auf kosovarischer Seite zu Organhandel gekommen sein soll, sind indes nicht Teil der Anklage gegen Thaci.
Am Mittwoch fällt in Den Haag ein Urteil, das die Debatte über das Erbe der Rebellenarmee UCK prägen wird. Agush Buja sieht sich und seine damaligen Weggefährten auf der richtigen Seite der Geschichte. Nach der Pensionierung als Taxifahrer möchte er seine Memoiren schreiben. Je länger der Krieg zurückliegt, desto wichtiger ist es ihm, seine Version festzuhalten.






tona në një mënyrë tjetër."
Buja kishte ikur në Zvicër që në vitet 1980. Presidenti i mëvonshëm i Kosovës, Hashim Thaçi, jetonte në këtë vend që nga viti 1994, banonte në Dietikon dhe studionte historinë e Evropës Lindore në Universitetin e Zürichut.
Buja tregon se atëherë e kishte njohur Thaçin dhe e kishte "mbështetur". "E solla në një shoqatë kulturore shqiptare në St. Gallen." Më vonë kontakti mes tyre u bë më i ngushtë. Të dy lëviznin në një rreth prej të cilit, brenda pak vitesh, do të dilte një pjesë e elitës politike dhe ushtarake të Kosovës.

## Fondi i atdheut

Një nga kapitujt më të rëndësishëm të kësaj historie nis në Winterthur. Që në fillim të viteve 1990, aty u mblodh një grup aktivistësh dhe krijoi të ashtuquajturin Fondi i Atdheut (Vendlindja Thërret). Këtë mund ta lexosh në dëshmitë e personave të kohës.
Me kalimin e viteve, fondi u bë shtylla financiare e UÇK-së dhe në fund mundësoi drejtpërdrejt blerjen e armëve dhe municioneve.
Agush Buja ishte pjesë e kësaj dhe konfirmon rrëfimet që deri tani njiheshin vetëm nga pak njerëz në Zvicër. "Udhëheqja e LPK-së u mblodh në vitin 1993 në sallën e një restoranti në Winterthur dhe diskutoi një pyetje qendrore: Si duhej financuar lufta?"
Përmasat e fondit për një periudhë duhet të kenë qenë enorme. Vetëm në Zvicër, thotë Buja, kishte më shumë se 1.000 persona të autorizuar për të mbledhur para nga diaspora.
"Dhjetëra mijëra njerëz dhuruan."
Zvicra u kishte lënë aktivistëve kosovaro-shqiptarë një hapësirë të konsiderueshme veprimi. Në korrik 1998, kur lufta e Kosovës kishte filluar tashmë, Prokuroria Federale ndërhyri. Ajo urdhëroi bllokimin e llogarisë së Fondit të Atdheut.
Buja u arrestua për pak kohë, ndërsa banesa e tij dhe zyra e fondit në Aarau u kontrolluan.
Hetuesit e morën në pyetje Bujën. Ai kishte dërguar një shumë të konsiderueshme parash në Shqipëri. A ishin blerë armë me ato para?
"Nuk e di", tha ai.
Edhe sot ai qëndron në këtë përgjigje. Paratë, thotë ai, ishin menduar për gjithçka që UÇK-ja dhe popullsia kishin nevojë: ushqime, rroba – "ndoshta edhe armë". Llogaria u zhbllokua më vonë dhe procedura kundër Bujës u mbyll në vitin 2004.
Edhe në raste të tjera të blerjeve të dyshuara të armëve nuk pati asnjëherë dënime nga autoritetet federale zvicerane, siç deklaron Prokuroria Federale. Kjo ndodhi, ndër të tjera, sepse të akuzuarit u arratisën ose mund të ndiqeshin penalisht në Shqipëri. Disa raste iu kaluan kantoneve.

## Si u mashtruan autoritetet

Një aksion që ende tregohet në rrethet e ish-aktivistëve kosovarë tregon se si atëherë u mashtruan autoritetet.
Në fillim të vitit 1999, mbështetës të UÇK-së siguruan disa dhjetëra kamionë ushtarakë zviceranë të nxjerrë jashtë përdorimit dhe i dërguan në Shqipëri. Autoritetet në Zvicër dhe Itali u lanë të besonin se kamionët do të përdoreshin vetëm për transportin e ndihmave humanitare.
Por, sipas aktivistëve, në Shqipëri kamionët u mbushën me armë dhe më pas u përdorën nga trupat tokësore në Kosovë për luftë.

## Akuza nga Ticino

Zvicra luan një rol të jashtëzakonshëm në gjithë këtë histori. Ajo u dha hapësirë veprimtarisë politike të udhëheqësve të mëvonshëm të UÇK-së, nga viti 1999 mori pjesë në misionin paqeruajtës të drejtuar nga NATO, KFOR, dhe në vitin 2008 e njohu Kosovën vetëm dhjetë ditë pas shpalljes së pavarësisë.
Në të njëjtën kohë, ishin pikërisht dy persona nga Ticino që sollën në qendër të vëmendjes akuza të rënda kundër UÇK-së: ish-prokurorja federale dhe kryeprokurorja e Hagës, Carla Del Ponte, si dhe raportuesi special i Këshillit të Evropës, tashmë i ndjerë, Dick Marty.
Akuzat e tyre, të cilat nuk janë provuar asnjëherë në gjykatë, se nga pala kosovare mund të ketë pasur trafikim organesh, nuk janë pjesë e aktakuzës kundër Thaçit.
Të mërkurën, në Hagë, do të jepet një vendim që do të ndikojë në debatin mbi trashëgiminë e ushtrisë kryengritëse UÇK.
Agush Buja e sheh veten dhe bashkëluftëtarët e tij të atëhershëm në anën e duhur të historisë.
Pas pensionimit nga puna si taksist, ai dëshiron të shkruajë kujtimet e tij.
Sa më shumë që largohet lufta në kohë, aq më i rëndësishëm bëhet...

**(Artikull i botuar në gazetën zvicerane "NZZ am Sontag")**

# ÇMIMET LART, PAZARET POSHTË: DY ANËT E TREGUT TË BANESAVE



PRISHTINË, 13 SHTATOR - Prishtina vazhdon të ketë disa prej çmimeve më të larta të pronave në Kosovë, por rritja më e madhe nuk po ndodh më në kryeqytet.
Në tremujorin e dytë të këtij viti çmimet e pronave të banimit në rajonet e tjera të Kosovës u rritën për 12.8 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.
Në Prishtinë, rritja ishte 4.1 për qind.
Në nivel vendi, pronat u shtrenjtuan për 7.3 për qind, sipas Indeksit të Çmimeve të Pronave të Banimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK).
Ekspertë të ekonomisë dhe përfaqësues të tregut thonë se qytetet e tjera po ndjekin trendin e Prishtinës - me më shumë ndërtime dhe çmime më të larta.
Por, ajo që shihet në treg nuk përfundon gjithmonë në kontratën e shitjes.
Në Prizren dhe Lipjan, për shembull, përfaqësues të agjencive të patundshmërive thonë se çmimet fillestare negociohen dhe, në disa raste, pronat shiten dukshëm më lirë.

## Qytetet e tjera ndjekin trendin e Prishtinës

Në Prishtinë çmimet e banesave aktualisht variojnë nga rreth 1 100 deri në 3 000 euro për metër katror, varësisht nga lagjja, ndërtuesi, cilësia e ndërtimit dhe infrastruktura.
Nagip Skenderi, profesor i Ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, thotë se rajone të caktuara "janë duke e kopjuar Prishtinën si shembull për ndërtimin dhe çmimin e banesave". "Si po bën Prishtina, tash po bëjnë edhe qytetet e tjera. Në disa qytete kanë filluar të ndërtohen ndërtesa pranë ndërtesave", thotë Skenderi për Radion Evropa e Lirë.
Me modelin e ndërtimit, sipas tij, është përhapur edhe një mënyrë financimi: shitja e banesave që në fazat e hershme të projektit.
Blerësit që paguajnë paraprakisht dhe me para të gatshme mund ta marrin pronën me çmim më të ulët, ndërsa investitori i përdor ato mjete për vazhdimin e ndërtimit. "Nëse është çmimi i planifikuar (për metër katror) 1 500 ose 1 300 euro, atij blerësi mund t'ia japë me 900 – 1 000 euro, në rast se ai e paguan me paradhënie. Ato mjete i investon, pastaj, në ndërtim. Ky sistem shpjegon ngritjen artificiale të vlerës në treg", thotë Skenderi.

## Prizreni i afrohet Prishtinës me çmime

Në Prizren diferenca me kryeqytetin është ngushtuar. Në qendër dhe në zonat pranë saj, çmimet e pronave të banimit variojnë nga 1 200 deri në 1 700 euro për metër katror, sipas Verim Morinës, pronar i agjencisë B-LUX Real Estate. Në periferi ato lëvizin nga 750 deri në 800 euro. "Do të thotë, Prizreni, pak a shumë, është i njëjtë me Prishtinën për nga çmimet. Por, mund të them se shitjet sivjet janë vetëm sa një e treta e vitit të kaluar", thotë ai, duke u bazuar në vëzhgimet e tij dhe jo në të dhëna të verifikuara nga ndonjë institucion.
Radio Evropa e Lirë kërkoi nga Agjencia Kadastrale e Kosovës të dhëna për trendin e shitjeve këtë vit dhe vitin e kaluar, por nuk mori përgjigje.
Brahim Selimaj nga Shoqata e Ndërtuesve të Kosovës thotë, po ashtu, se shitjet e pronave kanë rënë këtë vit krahasuar me dy vjetët e kaluar. Sipas tij, ky trend ka nisur më herët dhe lidhet, mes të tjerash, me ndryshimin e mënyrës se si diaspora po i orienton investimet. "Para dy vjetësh ka nisur rënia e shitjes së banesave, për shkak se diaspora ka nisur të investojë jashtë vendit", thotë Selimaj për Radion Evropa e Lirë.
Morina shton se, përballë shitjeve më të dobëta që ai vëren, është rritur edhe hapësira për negocim. "Çmimet e para janë të larta. Por, sivjet janë bërë pazare me shumë zbritje... Sivjet kanë nisur të bien çmimet, për arsye se edhe fuqia blerëse ka rënë", thotë ai. Sipas tij, kostoja e ndërtimit të një objekti banesor është e përafërt në gjithë Kosovën. "Një metër katror i një banese, që ta bësh mirë dhe kualitative, del diku 450 deri 500 euro", thotë Morina.
Në çmimin përfundimtar ndikojnë edhe lokacioni, ndërtuesi, cilësia e objektit dhe infrastruktura përreth.

## Në Lipjan kërkohet një çmim, shitet me një tjetër

Dallimi mes çmimit fillestar dhe atij të shitjes shihet edhe në Lipjan.
Pronari i një agjencie të patundshmërive atje, i cili kërkoi nga Radio Evropa e Lirë të mbetet anonim, thotë se investitorët po përpiqen t'i ndjekin çmimet e qyteteve të tjera, por jo gjithmonë arrijnë t'i realizojnë ato në shitje. "Janë duke u munduar t'i përcjellin trendet në qendrat tjera, por nuk po arrijnë. Po përpiqen të bëjnë ngritje çmimesh, që është artificiale, por nuk po u 'ndez'", thotë ai.
Në qendër të Lipjanit, sipas tij, çmimet fillestare mund të arrijnë deri në 1.100 euro për metër katror. Por, në fund, pronat shiten për më pak. "Çmimet e tregut në Lipjan varen nga zona. Për shembull, në zonën e qendrës, çmimet fillestare shkojnë deri në 1.100 euro (për metër katror), por jo se i shesin aq. Në qendër, maksimumi shiten 850 deri 900 euro. Në periferi, çmimet shkojnë nga 680 deri 700 euro, por nuk shiten më shumë se 650 euro", thotë ky bashkëbisedues.

## Çmimi në shpallje nuk është domosdoshmërisht vlera e pronës

Shembujt nga Prizreni dhe Lipjani nxjerrin në pah një dallim të rëndësishëm në tregun e patundshmërive: atë mes çmimit që kërkon shitësi dhe vlerës që prona arrin në treg.
Valon Januzi, vlerësues i licencuar i pronave të paluajtshme në kompaninë Paralel Consulting & Appraisals, shpjegon se çmimi i shpalljes mund të ndikohet nga pritjet personale të shitësit, hapësira për negocim apo mënyra se si pronari e percepton vlerën e pronës. "Ky çmim mund të jetë i arsyeshëm, por mund të jetë edhe më i lartë ose më i ulët se niveli që pranohet nga tregu… Prandaj, një shpallje tregon se me sa ofrohet prona, por jo domosdoshmërisht se sa vlen apo me sa mund të shitet", thotë Januzi për Radion Evropa e Lirë.
Sipas tij, te disa prona dallimi mes çmimit të shpallur dhe vlerës së tregut është i konsiderueshëm. "Vërehen gjithashtu prona që ofrohen për periudha të gjata, ndërsa një nga arsyet mund të jetë mospërputhja ndërmjet çmimit të kërkuar dhe nivelit që pranohet nga tregu", thotë Januzi.
Indeksi i ASK-së, ndërkaq, nuk mat çmimet e shpalljeve, por bazohet në transaksionet e regjistruara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe përfshin apartamente dhe shtëpi.
Të dhënat filtrohen për të përjashtuar raste të dyfishta dhe vlera të pazakonta.
Indeksi ka për bazë fillestare vitin 2018, ndërsa metoda e përdorur nga ASK-ja bazohet në praktikat e rekomanduara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

## Kur çmimet përballen me pagat

Nëse për shitësit çështja është se sa mund të marrin për një pronë, për shumë blerës pyetja është shumë më bazike: a mund ta përballojnë atë?
Sipas Skenderit, një pronë mesatare për banim kushton rreth 70.000 deri në 80.000 euro.
Paga mesatare në Kosovë është 713 euro bruto, ndërsa paga minimale 500 euro.
Skenderi thotë se, me këto nivele pagash, shumë qytetarë nuk mund të blejnë banesë pa financim bankar. "Nuk mundet ta blejë assesi pa hyrë në borxh ose pa marrë kredi në banka - me kushte aspak të volitshme - në të cilën e ngec vetveten për kthim për 20 deri në 30 vjet. Çmimet janë të larta dhe drastike në krahasim me koston sociale, respektivisht me standardin e jetesës në Kosovë", thotë Skenderi.
Rritja e çmimeve është shoqëruar ndër vite me shtimin e ndërtimeve dhe me zhvendosjen e popullsisë nga zonat rurale drejt qyteteve, ku është përqendruar një pjesë e kërkesës për banim.
Por, krahas ndërtimeve të reja dhe çmimeve në rritje, ekziston edhe një shifër tjetër: mbi 180 mijë banesa në Kosovë rezultojnë të pabanuara.

## Mbi 180 mijë banesa të pabanuara

Sipas të dhënave të ASK-së nga regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave i vitit 2024, në Kosovë janë regjistruar 182.849 banesa të pabanuara.
Kjo kategori përfshin banesa në të gjithë Kosovën dhe nuk nënkupton se të gjitha janë prona të reja apo të disponueshme për shitje.
Skenderi thotë se një pjesë e pronave të pashfrytëzuara janë blerë nga mërgimtarë nga Kosova, të cilët kanë investuar në patundshmëri, por nuk jetojnë rregullisht në to. "Këtë do ta quaja investim gjysëm i vdekur, në kuptimin që e blen një banesë dhe nuk e shfrytëzon në tërësi, sepse nuk jeton në Kosovë. Ndërkaq, përpiqen që investimet t'i kthejnë përmes qiradhënies, e jo gjithmonë arrijnë t'i japin me qira", thotë Skenderi.
Ai shton se numri i pronave të pashfrytëzuara lidhet edhe me ritmin e ndërtimeve.
"Kjo ndodh për shkak të fluksit të madh të ndërtimit. Blerësit, të cilët i kanë investuar paratë, në njëfarë mënyre po e rrezikojnë investimin e tyre, sepse nuk e shfrytëzojnë banesën, e as nuk mund ta lëshojnë me qira", thotë ai.

## Patundshmëritë, destinacioni kryesor i investimeve të huaja

Megjithatë, patundshmëritë vazhdojnë të tërheqin qindra miliona euro investime.
Të dhënat publike të Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se gjatë vitit 2025 investimet e huaja arritën në rreth 1.1 miliard euro, prej të cilave rreth 770 milionë euro shkuan në aktivitete të patundshmërisë.
Në periudhën janar-qershor të vitit të kaluar, investimet e huaja në patundshmëri ishin rreth 351 milionë euro.
Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, investimet e huaja në Kosovë arritën në rreth 467 milionë euro. Rreth 317 milionë euro prej tyre shkuan në aktivitete të patundshmërisë. Kjo shumë ishte rreth 34 milionë euro më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

# POPULISTËT PRETENDOJNË SE FLASIN NË EMËR TË 'POPULLIT'. PO PËR KË PO FLASIN NË TË VËRTETË?

Clara Juarez MIRO

Universitat de Barcelona



Ndërsa mbështetja për lëvizjet populistët po rritet me shpejtësi në mbarë botën, termi "populizëm" është shndërruar në një lloj termi në modë. Ai përdoret për të përshkruar lëvizje dhe figura publike shumë të ndryshme, në kontekste politike po aq të ndryshme. Këtu përfshihen figura të së djathtës si Jair Bolsonaro në Brazil dhe Narendra Modi në Indi, por edhe të majtë si Bernie Sanders në SHBA, Pablo Iglesias në Spanjë dhe Julius Malema në Afrikën e Jugut.

Për ta komplikuar edhe më tej çështjen, studiuesit priren të përdorin përkufizime të ndryshme të populizmit. Disa e konsiderojnë një ideologji, të tjerë një lloj diskursi, madje edhe një formë qeverisjeje. Pavarësisht këtyre dallimeve, shumica e përkufizimeve bien dakord mbi një ide themelore: populizmi e ndan shoqërinë në dy grupe kundërshtare: "popullin e pastër" dhe "elitat e korruptuara".

Koncepti i "popullit" është themeli i populizmit, por ne ende dimë relativisht pak se çfarë do të thotë realisht për mbështetësit ta shohin veten si pjesë të këtij grupi. Një pjesë e madhe e kërkimeve është përqendruar te vetë partitë dhe udhëheqësit populistë, përfshirë mënyrën se si ata e paraqesin versionin e tyre të "popullit" si moralisht superior ndaj elitave të korruptuara. Kërkimi im shqyrton anën tjetër, për të kuptuar se çfarë do të thotë kjo për mbështetësit që, përmes votës së tyre, i sjellin këta politikanë në pushtet.

### Një koncept pafundësisht elastik

Disa autorë kanë argumentuar se paqartësia se kush është në të vërtetë "populli" përbën pikërisht një nga elementet kyçe të fuqisë tërheqëse të populizmit. Duke qenë se ideja është e gjerë dhe elastike, ajo mund të kalojë nga një vend në tjetrin dhe nga një ideologji politike në tjetrën, duke u mundësuar grupeve të ndryshme të votuesve të identifikohen me të dhe ta imagjinojnë veten si pjesë të së njëjtës bashkësi më të gjerë.

Dhe kjo nuk vlen vetëm për "popullin". Terma të tillë si "establishmenti" ose "elitat" përdoren në mënyrë të ngjashme për të identifikuar, në kuptim të gjerë, ata që nuk janë pjesë e "popullit".

Ky elasticitet do të thotë se njerëzit që përfshihen brenda konceptit të "popullit" mund të ndryshojnë jashtëzakonisht shumë.

Politikanët mund ta përdorin termin për t'iu referuar atyre që ndajnë një identitet të caktuar kulturor, siç bën populistja franceze e së djathtës Marine Le Pen kur e përdor këtë koncept për të promovuar politika që u japin përparësi qytetarëve francezë.

Në mënyrë të ngjashme, të tjerë e përdorin termin si diçka që përputhet drejtpërdrejt me përkatësinë kombëtare. Për shembull, partia populiste e së djathtës radikale spanjolle Vox pretendon shpesh se flet në emër të "popullit spanjoll".

Të tjerë, si populistja gjermane Sahra Wagenknecht – pozicioni politik i së cilës ndërthur elemente të së majtës dhe së djathtës radikale – e përdorin termin për t'iu referuar grupeve në vështirësi ekonomike. Për shembull, ajo mbron ata që, sipas saj, janë "harruar prej vitesh nga politikanët", duke kërkuar paga më të larta dhe përfitime sociale më të forta.

Megjithëse anëtarët e këtij grupi të imagjinuar mund të jenë krejtësisht të ndryshëm, populistët e të gjitha krahëve e paraqesin "popullin" si një grup të bashkuar dhe moralisht të mirë, interesat e të cilit po shpërfillen ose tradhtohen nga elitat e korruptuara.

Figurat dhe partitë populiste e paraqesin veten si zgjidhjen, si një forcë që është në mënyrë unike e aftë të kuptojë dhe t'i shërbejë një elektorati të shtypur dhe të lënë pas dore.

Po aq e rëndësishme sa të shohim se kë përfshijnë politikanët në këtë bashkësi të imagjinuar është të shohim edhe kë përjashtojnë prej saj. Në të djathtë, ky përjashtim shpesh bëhet mbi baza kulturore ose racore, ndërsa e majta zakonisht përjashton klasat më të pasura të shoqërisë.

Politikanët populistë madje mund të sugjerojnë se kushdo që nuk pajtohet me ta nuk i përket në të vërtetë "popullit". Populisti britanik dhe një nga arkitektët e Brexit-it, Nigel Farage, e shprehu këtë në kuptimin më të drejtpërdrejtë të mundshëm kur tha: "Ne jemi populli. Partia Brexit është populli."

### Mbështetësit e populistëve

Studimet e mëparshme kanë matur se sa fort votuesit identifikohen me "popullin". Megjithatë, për të kuptuar më mirë se çfarë do të thotë t'i përkasësh këtij grupi, duhet të bëjmë edhe një hap pas dhe të shqyrtojmë interpretimet, emocionet dhe përvojat që mbështetësit lidhin me këtë bashkësi të imagjinuar.

Një mënyrë për ta bërë këtë është të bisedosh me mbështetës të lëvizjeve të ndryshme populiste, për të kuptuar se çfarë nënkupton për ta të qenit pjesë e "popullit".

Një mënyrë tjetër është të shqyrtosh komunikimin mes këtyre mbështetësve në komunitetet online. Këto hapësira, të pakufizuara gjeografikisht, u mundësojnë njerëzve të interpretojnë së bashku mesazhet politike, të zhvillojnë një ndjenjë të përbashkët identiteti dhe përkatësie dhe të negociojnë se kush përfshihet, dhe kush përjashtohet, nga "populli".

Në një studim të kohëve të fundit, analizova 6.000 ndërveprime në komunitete online, si dhe 33 intervista të thelluara me mbështetës populistë të djathtë dhe të majtë.

Analiza tregoi se mbështetësit populistë identifikoheshin me "popullin" në tri mënyra: përmes mënyrës se si e imagjinonin këtë grup, mënyrës se si ndiheshin ndaj tij dhe mënyrës se si e përjetonin të qenit pjesë e tij.

Siç kanë sugjeruar edhe kërkimet e mëparshme, mbështetësit shpesh e imagjinojnë "popullin" si njerëz punëtorë, të denjë dhe moralisht legjitimë. Mbështetësit e së djathtës e lidhin këtë identitet me përkatësinë kulturore, ndërsa ata të së majtës theksojnë identitetin e klasës punëtore.

Por ky identifikim është gjithashtu thellësisht emocional. Mbështetësit shprehin afeksion dhe besnikëri të fortë ndaj politikanëve të tyre të preferuar populistë, ndërsa shfaqin zemërim dhe frikë ndaj elitave, kundërshtarëve dhe grupeve që i perceptojnë si kërcënim për komunitetin.

Ata shprehin gjithashtu dashuri dhe mirëkuptim të thellë për anëtarët e tjerë të "popullit", qoftë kur ky komunitet është më abstrakt, qoftë kur përbëhet nga njerëz konkretë me të cilët komunikojnë online ose në jetën reale.

Ata e përjetojnë "popullin" edhe përmes marrëdhënieve dhe pjesëmarrjes politike. Ndërveprimi me njerëz të tjerë që perceptohen si pjesëtarë të "popullit" krijon një ndjenjë përkatësie, konfirmimi dhe qëllimi, ndërsa aktiviteti politik, qoftë fizikisht, në tubime dhe protesta, apo online, mund ta forcojë këtë ndjenjë komuniteti dhe të nxisë pjesëmarrje të mëtejshme.

Të marra së bashku, këto gjetje sugjerojnë se mbështetja për populizmin nuk lidhet vetëm me idetë apo politikat.

Identifikimi me "popullin" funksionon sepse elasticiteti i këtij termi u mundëson politikanëve ta formësojnë atë në mënyra bindëse dhe sepse interpretimet e mbështetësve përputhen me këto mesazhe politike.

Por ky identifikim përmban edhe një aspiratë: u ofron një ndjenjë komuniteti dhe përkatësie atyre që arrijnë ta shohin veten si pjesë të këtij grupi.

Ai i ndihmon mbështetësit të ndiejnë se i përkasin diku, se të tjerët i kuptojnë dhe se janë të lidhur me një qëllim të përbashkët.

**The Conversation – Bota.al**

# MARRAMENDËS - OKB PARALAJMËRON PËR AFRIMIN E NJË EL NIÑO REKORD

**"El Niño po superdimensionohet para syve tanë. Shkenca nuk lë vend për dyshime: planeti ndodhet në ujëra të paeksploruara dhe këto ujëra po nxehen. Bota është në zonën e rrezikut të motit ekstrem. Gara tani është mes rreziqeve në rritje dhe angazhimit tonë për të ndërmarrë veprime klimatike dhe për të mbrojtur njerëzit"**



Fenomeni klimatik El Niño po "super-zmadhohet para syve tanë", ka deklaruar OKB-ja. Sipas parashikimeve më të fundit, është pothuajse e sigurt se ky fenomen do të thyejë rekordet e temperaturave. Ka të ngjarë të jetë më i madhi në të paktën 1.000 vjet dhe do t'i shtojë edhe më shumë nxehtësi një atmosfere ku temperaturat tashmë po rriten me shpejtësi për shkak të ngrohjes globale. Kjo do të thotë se viti 2027 parashikohet të "shkatërrojë" rekordin dhe të jetë viti më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë.

Rritja e temperaturave nga El Niño tashmë po sjell pasoja, nga zjarret në Indonezi te dobësimi i reshjeve jetike të musoneve në Indi. Ndikimet do të përhapen në të gjithë globin, nga rritja e rrezikut të zjarreve në Australi te përmbytjet më intensive në Amerikën e Jugut. Programi Botëror i Ushqimit deklaroi muajin e kaluar se El Niño aktual kishte gjasa të shtynte rreth 50 milionë njerëz drejt urisë akute.

Kriza klimatike, e shkaktuar nga ndotja prej lëndëve djegëse fosile, tashmë po i fuqizon fenomenet ekstreme të motit dhe po vret njerëz; vala më ekstreme e të nxehtit e regjistruar ndonjëherë goditi Europën këtë verë dhe çoi në të paktën 35.000 vdekje. El Niño do t'i përforcojë edhe më tej këto pasoja, ndërsa përmasat e fenomenit janë përshkruar si "vërtet marramendëse".

El Niño është një cikël natyror klimatik, gjatë të cilit ndryshimet e erërave mbi Paqësor çojnë në rritjen e temperaturave të oqeanit dhe në transferimin e sasive të mëdha të nxehtësisë në atmosferë. Të dhënat më të fundit, të 31 gushtit, tregojnë se temperatura e oqeanit në zemër të El Niño-s është 2,6°C mbi mesataren 30-vjeçare. Kjo tashmë është pranë anomalive më të larta të regjistruara ndonjëherë në epokën e të dhënave satelitore: 3,1°C në vitin 2015, ndërkohë që kanë mbetur ende disa muaj deri në kulmin e pritshëm.

Sipas mesatares së 14 modeleve të ndryshme, ky kulm parashikohet të arrijë rreth 4°C në nëntor. Analizat e koraleve, unazave të pemëve dhe dokumenteve historike sugjerojnë se El Niño nuk e ka arritur këtë nivel gjatë mijëvjeçarit të fundit, tha Zeke Hausfather, analist i klimës. Çdo anomali temperature mbi 0,5°C klasifikohet si El Niño.

El Niño, ciklet po intensifikohen

Një shqetësim tjetër është se kërkimet e fundit tregojnë se ngrohja globale po i intensifikon vetë ciklet e El Niño-s, të cilat më pas, nga ana e tyre, i përforcojnë ndikimet e krizës klimatike.

"El Niño po superdimensionohet para syve tanë," tha Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, António Guterres. "Shkenca nuk lë vend për dyshime: planeti ndodhet në ujëra të paeksploruara dhe këto ujëra po nxehen. Bota është në zonën e rrezikut të motit ekstrem. Gara tani është mes rreziqeve në rritje dhe angazhimit tonë për të ndërmarrë veprime klimatike dhe për të mbrojtur njerëzit."

"El Niño ka potencialin t'u japë një goditje masive komuniteteve dhe ekonomive në mbarë botën," tha Celeste Saulo, sekretare e përgjithshme e Organizatës Botërore Meteorologjike të OKB-së (WMO). "Tashmë po shohim ndërprerje dhe shkatërrim nga thatësirat dhe përmbytjet dhe presim që këto ndikime të shtohen ndërsa El Niño intensifikohet."

Përditësimet e WMO-së për El Niño-n janë parashikimet më autoritative në botë dhe bazohen në një konsensus modelesh nga qendrat e parashikimit klimatik në mbarë botën. Përditësimi më i fundit, i publikuar javën e kaluar, thoshte se El Niño do të intensifikohej në një "fenomen shumë të fuqishëm" gjatë muajve të ardhshëm, me "ndikime të mëdha", përfshirë përmbytje, thatësira dhe nxehtësi ekstreme që do të vazhdojnë gjatë vitit 2027. Në disa zona, temperaturat e oqeanit nën sipërfaqe ishin jashtëzakonisht 8°C mbi mesataren gjatë korrikut dhe fillimit të gushtit.

Chris Jaccarini, nga Energy and Climate Intelligence Unit në Mbretërinë e Bashkuar, tha: "Moti ekstrem në mbarë botën ka rritur çmimet e ushqimeve, duke goditur më fort më të varfrit. Nuk bëhet fjalë vetëm për ushqimet që importojmë, por edhe për ato që kultivojmë në vend." / bota.al

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova

MINISTIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS | MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE | MINISTARSTVO PROSVETE I NAUKE

QENDRA E STUDENTËVE | STUDENT CENTER | STUDENTSKI CENTAR

Rruga "Agim Ramadani" p.n. 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel:. +383 (0) 38/223-951, +383 (0) 38/225-976
web: qs.rks-gov.net

**Qendra e Studentëve në Prishtinë shpallë:** 14.09.2026

## KONKURS

Për pranimin e studentëve në konvikte dhe ushqim në mensën e studentëve për vitin Akademik 2026/2027.

Aplikimi bëhët përmes sistemit **ONLINE**. Linku për aplikim është i publikuar në web faqen zyrtare të QS-së **qs.rks-gov.net** dhe në profilin zyrtar në facebook **Qendra e Studenteve-Prishtine**. Udhëzuesi për aplikim gjendet në linkun e shfaqur.

Për konviktet dhe mensën e QS-së kanë të drejtë aplikimi të gjithë studentët e rregullt në studime themelore, vendbanimi i të cilëve është 25 km e më larg nga Prishtina.

**Kriteret për pranim dhe pikët e mundshme:**

1. Studentët nga Fakulteti i Mjekësisë, Fakulteti Teknik dhe Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore me notë mesatare 9.00 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina, pranohen në konvikte pavarësisht totalit të pikëve që fitojnë.
2. Studentët nga fakultetet e tjera me notë mesatare 9.5 dhe me largësi 25 km e më shumë nga Prishtina pranohen në konvikte pavarësisht numrit të pikëve të fituara.
3. Studentët për notë mesatare fitojnë (varësisht nga nota mesatare)…..….5 - 15 pikë
4. Largësia e vendbanimit nga Komuna e Prishtinës – pikët ……….......…1 - 10 pikë
5. Studentët jashtë territorit të Republikës për largësi marrin….………..……..15 pikë

**Studentët me status të vaçantë për pikë shtesë sipas kategorive:**

1. Student (fëmijë) i dëshmorit ------------------------------------------10 pikë
2. Student (fëmijë) i prindit invalid të luftës --------------------------5 pikë
3. Student, prindi i të cilit është veteran i luftës -----------------------3 pikë
4. Student i prindit martir nga lufta --------------------------------------4 pikë
5. Student me aftësi të kufizuara ----------------------------------------6 pikë
6. Student pa të dy prindërit ……………………………………….5 pikë
7. Student i të burgosurit, politik -----------------------------------4 pikë
8. Student me asistencë sociale -----------------------------------------4 pikë
9. Dy e më shumë studentë nga një familje aplikant në QS ………3 pikë

Të gjithë studentët e këtyre kategorive të cilët përfitojnë pikë shtesë duhet që përmes sistemit ONLINE të ngarkojnë dokumentacionin e kërkuar (çertifikaten) nga Ministrit përkatse.
Tri kategorit në vazhdim në pamundsi të dokumentit të kërkuar më lart çertifikatën ose vërtetimin nga:

- **Shoqata e të Burgosurve Politik, zyra qëndrore Prishtinë**
- **Shoqata e personave me Aftësi të Kufizuara – Hendikos, zyra qëndrore Prishtinë**
- **Shoqata e familjeve te deshmoreve – Selia qendrore ne Prishtinë**
- **Student pa të dy prindërit, dëshmin-çertifikaten mbi vdekjen e prindërve nga Kuvendi Komunal.**

- **Studenti i prindit martir nga lufta, vendimi i MPMS dhe çertifikata e bashkësisë familjare.**

- **Studentët prindërit e të cilëve janë veteran e të cilët marrin pagë nga Buxheti i Republikës së Kosoves e ngarkojnë çertifikaten e prindërve të lëshuar nga Qeveria e Republikes së Kosoves, ndërsa studentët prindërit e të cilëve nuk marrin pagë nga Buxheti i Republikes së Kosoves nuk kanë nevojë t'a bëjnë ngarkimin e çertifikatës së prindit veteran, sepse pikët ju llogariten nga vet sistemi nga të dhënat e MPMS.**

**Sqarim**: Njoftojmë studentët se pikët e fituara nga nota mesatare, nga largësia, student i prindit invalid të luftës, studentëve me asistencë sociale pikët i llogarit vet sistemit online. Andaj nuk është e nevojshme që këto dokumente të ngarkohen gjatë aplikimit.

- **Te kategoria dy e më shumë studentë nga një familje, aplikuesi për vendosje në QS me rastin e aplikimit studenti i dytë apo i tretë nga e njejta familje, duhet të shkruaj nr. e letërnjoftimit të aplikantit të parë në opsionin e hapur për këtë kategori.**

- **Për studentët nga radhët e komuniteteve jo shumicë vlenë lista nga sistemi i UP-së.**

- Konkursi mbetet i hapur deri me datën **18.09.2026 ora 16:00** nga dita e shpalljes.

. Studentët që kanë thyer Rregulloret në fuqi në Qendrën e Studentëve nuk do të pranohen në konvikte.

- Në konvikte do të pranohen studentët me numrin më të madh të pikëve të fituara.

Publikimi i rezultateve bëhet me datë **25.09.2026** në tabelat e konvikteve dhe faqet zyrtare të QS.

- Afati për ushtrimin e ankesave **ONLINE** është **28 – 29.09.2026**.

- Publikimi i rezultateve të ankesave bëhet me datën **01.10.2026.**

